



RAPORT



**MONITORIMI I GJUHËS SË URREJTJES,
DISKRIMINUESE DHE SEKSISTE NË
MEDIAT ONLINE DHE TELEVIZION**

Periudha e monitoruar
Mars-Qershor 2021



MONITORIMI I MEDIAS

Gjuha e urrejtjes, diskriminuese dhe seksiste



Liria e shprehjes është e drejtë themelore civile dhe politike e kualifikuar si e drejtë themelore e njeriut.

VS.

Gjuha e urrejtjes shpreh manifestim të urrejtjes dhe përdoret që të ofendohet një grup apo person për shkak të përkatësisë së tij/saj.

Liria e mendimit është e drejtë absolute qytetare, që do të thotë se askush nuk mund të kufizojë të menduarit e njeriut.

VS.

Diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, preferencë, që ka si qëllim pengesën e ushtrimit të të drejtave e lirive themelore nga të tjerët.

HYRJE

Historia Ime për të shtatin vit radhazi prodhon raportin e saj të monitorimit të medias. Ky raport ka si qëllim që të shfrytëzohet nga një sërë institucionesh dhe aktorësh në Shqipëri, të cilët kanë një rol në avancimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen nga diskriminimi për të gjitha grupet në nevojë.

Me rëndësi është që gjetjet e këtij monitorimi do të ndihmojnë drejtuesit dhe profesionistët e mediave online në Shqipëri- siç janë gazetarët - që të ndërgjegjësohen më mirë tek ndikimi i punës së tyre të përditshme në krijimin e realiteteve sociale për një sërë kategorish, si: gratë, komuniteti LGBTI, aftësia e kufijzuar, raca, përkatësia fetare etj. Gjithashtu mendojmë se duke evidentuar disa qasje të profesionistëve të medias si online ashtu dhe në televizionet gjatë emisioneve *Prime Time* veçanërisht përsa i përket mënyrës së përzgjedhjes së lajmeve që përmbajnë gjuhë të urrejtjes apo diskriminuese, do të rrisim ndërgjegjësimin e tyre, për përmirësimin e këtyre praktikave, rritjen e cilësisë së informacionit që ofrohet dhe shmangien e përdorimit të gjuhës së urrejtjes apo diskriminuese në media.

Së dyti, shpresojmë që ky raport t'u jap një pamje më të qartë institucioneve në Shqipëri që merren drejtpërdrejtë me çështje të medias dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, apo Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). Gjetjet e këtij monitorimi mund t'u vijnë në ndihmë këtyre institucioneve, për të pasur evidenca në përmirësimin e kushteve të portretizimit të grupeve në nevojë në media apo fokusimin e përpjekjeve për ato grupe të cilat evidentohen në këtë studim, si më të prekurat nga gjuha e urrejtjes/diskriminimi.

Së treti, ky raport mund t'u vijë në ndihmë të gjitha atyre organizatave joqeveritare të cilat në punën e tyre e vënë fokusin tek mbrojtja e të drejtave të grupeve në nevojë.

Së fundmi, ky raport synon të ndërgjegjësojë publikun dhe përdoruesit e shpeshtë të mediave online, duke rritur njohuritë për çështje të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në media dhe duke i pajisur ata me aftësi konkrete se si të dallojnë dhe shmangin gjuhën e urrejtjes në media. Për këtë qëllim, gjatë gjithë këtij raporti, gjuha e përdorur do të jetë sa më e kuptueshme dhe praktike, për të gjithë lexuesit.


1. Mjedisi mediatik në Shqipëri

Sipas burimeve të ndryshme të cilat do listohen më poshtë në Shqipëri aksesit në internet në raport me popullsinë për akses në internet është i lartë. Psh. Sipas Censit të Popullsisë dhe Banesave të Shqipërisë 2020 Përgatitur nga INSTAT¹, më 30 qershor 2017, janë numëruar 1,932,024 përdorues të internetit në Shqipëri nga një popullsi prej 2,911,428 personash². Kjo tregon një shkallë penetrimi në internet prej 66.4%, krahasuar me një normë mesatare prej 80.2% për të gjithë Evropën.

Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në Shqipëri, në vitin 2017 numëroheshin 2.16 milion abonentë me akses në internet³.

“Bazuar në rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit (TIK) gjatë vitit 2020, nga grup-mosha 16 - 74 vjeç, e përdorin internetin 72,2 % e popullsisë, nga të cilët 88,2 % e përdorin çdo ditë”⁴.

Fig.1 Pajisjet kryesore të përdorura për të hyrë në internet 2019 -2020, në %



Burimi grafikut: shih referencën numër 4. Instat

¹ http://www.instat.gov.al/media/5127/2020-census-strategy-and-planning-document_alb.pdf

² <https://www.internetworldstats.com/stats4.htm>

³ Censusi 2011.

⁴Tiranë, më 02 Prill 2021, INSTAT, http://www.instat.gov.al/media/8267/ict-2020_shqip_.pdf aksesuar online datë 07-07-2021.

Të gjithë këto të dhëna theksojnë rëndësinë e cilësisë së portaleve mediatike të cilat aksesohen nga grupmosha të ndryshme në Shqipëri dhe informacioni që përcjellin. Ky numër kaq i lartë aksesit në internet, ka bërë që në Shqipëri të ketë një rritje të madhe të kanaleve online të raportimit, të ashtuquajtura media online. Sipas një raporti të Monitorit të Pronësisë së Medias (Media Ownership Monitor for Albania⁵), në Shqipëri ka më shumë se 650 website lajmesh që operojnë online. Vetëm 62 prej tyre drejtohen nga gazetarë- gjë e cila e vë në pikëpyetje cilësinë e ofruar nga këto 'media'. Një prezencë kaq e lartë e mediave online në një vend kaq të vogël, mund të bëhet shkak për përforsimin e gjuhës së urrjetjes online, duke marrë parasysh edhe faktin që në Shqipëri- ashtu si edhe në vende të tjera- mungojnë mekanizmat e duhur për të monitoruar dhe adresuar përmbajtjen e mediave online⁶.

Në Shqipëri ka një kuadër ligjor dhe rregullator që shërben për të parandaluar gjuhën e urrjetjes, diskriminuese e ofenduese për mediat.

Diskriminimi është subjekt i Ligjit Nr. 10 221 'Për Mbrojtjen nga diskriminimi' miratuar në 2010. Në këtë ligj termi diskriminim është përcaktuar si:

“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji [gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër], që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Gjithashtu neni 265 i Kodit Penal thotë:

“Nxitja e urrjetjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.”

Ligji i barazisë gjinore në nenin e 26-të mbi Trajtimi I Barabartë Dhe Mbrojtja Nga Diskriminimi Për Shkak Të Gjinisë Në Media thekson:

1. Media ndihmon në rritjen e vetëdijes së përgjithshme për barazinë e femrave dhe të meshkujve: a) përmes raportimit jodiskriminues mbi baza gjinore; b) përmes përdorimit të terminologjisë neutrale në aspektin gjinor; c) përmes shmangies së stereotipave gjinorë në veprimtarinë e vet.
2. Ndalohet transmetimi, botimi dhe publikimi i materialeve dhe i informacioneve, që përmbajnë apo nënkuptojnë dallime poshtëruese apo fyese, përjashtime apo kufizime të njëjës prej gjinive, në bazë të diskriminimit për shkak të gjinisë.

⁵ Reporti mund të lexohet këtu: <http://albania.mom-rsf.org/en/>

⁶ Emiljano Kaziaj 2020, Raport monitorimi Media Online <https://www.historiaime.al/feminizmi/raporti-i-plote-i-monitorimit-te-medias-mbi-gjuhen-e-urritjes-seksiste-dhe-diskriminuese/>

Fokusi mbi median në Shqipëri është kryesisht mbi atë tradicionale siç është Televizioni, dhe kuadri ligjor ato parashikon së shumti dhe janë subjekt i AMA. Duke parë trendin në rritje të përdorimit të medias online siç janë portalet e ndryshme ka lindur nevoja për një rregullim më efikas dhe debati lidhur me këtë temë po gjen terren të trajtohet. Ky studim shërben pikërisht si një instrument që mat gjuhën diskriminuese dhe të urrejtjes dhe të nevojës për një mënyrë rregullimi të portaleve. Studime të kësaj natyre do shërbejnë për të ngritur çështjen e rregullimit të medias online me profesionistët e medias, në mënyrë që realiteti social që këto të fundit krijojnë të jetë më pranues për grupet vulnerabël.



MONITORIMI I MEDIAS

Gjuha e urrejtjes, diskriminuese dhe seksiste



4 MEDIA TË
MONITORUARA



57 ARTIKUJ TË
MONITORUAR



67 SERI TË 2
EMISIONEVE



15%

Në vetëm 15% të
rasteve u jepet fjala
të parave grave.

Në emisionet televizive të
monitoruara, Open në Top
Channel dhe Opinion në Tv
Klan.

93%

93% e artikujve
problematikë të
evidentuar
targetojnë gratë

të monitoruara në portalet
shqiptarja.com dhe syri.net

Gjyqtarja "seksi" e Elbasanit namin në "Tik-Tok", kthen
zyrën në pasarelë modelingu, në 2019 liroi nga burgu të
fortin e... (Foto)

FOTO| Arjola Demiri: Me mua në pushtet bëni seks
dhe qejf

Enkel Demi: Rama, Erdoganist i pa
bërë synet

0%

Të ftuar nga komunitete
të margjinalizuara

2. Metodologjia dhe qëllimi i këtij raporti

Për një periudhë 3 mujore Historia Ime ka monitoruar dy emisione që transmetohen në televizionet kombëtare Top Channel dhe Klan TV, përkatësisht emisionet: Open dhe Opinion në një total prej 67 emisionesh.

Kemi zgjedhur këtë kampion pasi njëri drejtohet nga një moderatore grua dhe tjetra nga një moderator burrë.

Qëllimi i këtij monitorimi është evidentimi i gjuhës së urrejtjes, asaj diskriminuese dhe seksiste, dhe kur ndalim të gjuha seksiste, vlen për tu theksuar rritja e rasteve të seksizmit në median vizive dhe atë online gjatë periudhës së fushatës elektorale, e cila u shënua me raste flagrante targetimi të grave kandidatë me qëllim përfitimin politik.

Ndërsa portalet online përzgjedhëm *syri.net* dhe *shqiptartja.com* të cilët kanë trafik përkatësisht syri.net është në vend të 7-të për nga klikimet dhe *shqiptartja.com* në vend të 28-të⁷.

Qëllimi i këtij raporti është evidentimi i gjuhës së urrejtjes dhe gjuhës diskriminuese në mediat online, por dhe të pjesëmarrjes së grave dhe vajzave, tematikat e përzgjedhura dhe koha televizive drejtuar grave duke u fokusuar në:

- Format me të cilat shprehet gjuha e urrejtjes/ diskriminuese,
- Grupet më të prekura nga gjuha e urrejtjes/diskriminuese,
- Tematikat në të cilat gjuha e urrejtjes/diskriminuese, është më e përhapur,
- Karakteristika të lajmeve që kanë gjuhë urrejtje në përmbajtje të tyre (tituj, autorë, etj.),
- Karakteristika të personave apo grupeve që janë viktimë e gjuhës së urrejtjes,
- Reagimin e audiencës (komentet e lexuesve) në artikujt që përmbajnë gjuhë të urrejtjes/diskriminuese.

⁷ Sipas www.Alexa.com

3 . Gjetjet

3.1 Prime time TV shows dhe krahasimi me vitet e tjera

- Ka pasur dhjetëra raste shkeljesh së të drejtave të grave, raste targetimi seksist, raste abuzimi dhe dhune seksuale, që nuk janë mbuluar në asnjë prej temave të emisioneve në fjalë, ndërkohë që komunitetet e tjera të marginalizuara, *janë injoruar tërësisht* gjatë gjithë kësaj periudhe të ngarkuar me debat politik dhe premtime elektorale.
- Të ftuarat gra ishin të pakta ose ka patur raste që nuk ka patur gra të ftuara gjatë gjithë ditëve të transmetimit të emisionit.
- Një element tjetër i rëndësishëm është gjithashtu edhe fakti se përgjithësisht në pjesën më të madhe të kohës gjatë transmetimit të emisioni të ftuarëve burra iu jepej fjala të parëve në raport me gra.
- Përgjithësisht temat e trajtuara kanë përmbajtje politike, kjo vihet re më tepër tek emisioni Open, ku janë të shumta debatet mbi këto çështje.
- Problemet e grave dhe grupeve të marginalizuara në lidhje me zgjedhjet, trajtohen perceptazi. Njëkohësisht në rastet e përbaljeve verbale apo përdorimit të gjuhës jo-etike, nuk ka pasur moderim të debatit.
- Një tjetër gjetje shqetësuese është se grupet e marginalizuara, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, komunitetet LGBT, rom, egjiptian etj, lihen në harresë duke mos iu kushtuar rëndësi problemeve me të cilat ato hasen.

3.1.1 Pjesëmarrja

- Gjithsej nga 67 seritë e dy emisioneve të monitoruara për këtë studim, kanë qenë **340** të ftuar. Prej tyre **251 burra** dhe **89 gra**. E shprehur në përqindje, **74 % e të ftuarëve në emisionet e monitoruara kanë qenë burra dhe vetëm 26 %, gra**.
- Kjo përqindje vjet ka qenë 27% gra dhe 73% burra por duke qenë se kampionet janë të ndryshëm kësaj here nuk po e interpretojmë si ulje të pjesëmarrjes së grave më tepër sesa një qëndrim nga ana e moderatorëve dhe mediave për të ftuar gjithmonë vetëm 1/4 e grave nëpër emisione dhe burrat të zënë hapsirë rreth 3/4.
- Pjesëmarrja e grave është më e madhe në ato emisione që konsiderohen se kanë edhe një element argëtimi apo tema sociale. Ka një mungesë të madhe të pjesëmarrjes së grave në emisione që perceptohen se trajtojnë çështje me interes të madh politik dhe shoqëror.
- Gjatë gjithë periudhës së monitorimit nuk ka pasur asnjë të ftuar i cili të vetëidentifikohet si anëtarë i komunitetit LGBTI, apo minoriteteve të tjera në Shqipëri. Një mungesë e madhe e zërave dhe perspektivave nga anëtarë të minoriteteve të tjera është një nevojë tejet problematike që duhet adresuar sa më parë në median shqiptare.

3.1.2 Trajtimi

- Vazhdon të përsistojë tendenca për t'i dhënë më shumë hapësirë pjesëmarrësve burra sesa grave. Duke analizuar hapësirën televizive për t'u shprehur dhe numrin e pyetjeve si dhe cilësinë e pyetjeve të drejtuara vihet re se **hapësira mediatike është e burrave**.
- Vetëm 15% të rasteve i jepet e drejta për të folur e para një gruaje në emisionet e monitoruara.
- Burrat intervistohen për profesionalizmi, apo përvoja të punës, ndërsa gratë e intervistuar (edhe pse mund të jenë në të njëjtin profesion) pyeten më shumë për rolet e tyre si mama, bashkëshorte apo çështje të tjera që mund të perceptohen si femërore.
- Vërehet edhe një mungesë e thellë e përfaqësimit të grave dhe zërit të tyre në disa prej temave dhe emisioneve që perceptohen si shumë të fortë dhe në studio ka vetëm burra.
- Drejtuesit e emisioneve (sidomos Opinion) kanë një tendencë për të bërë një zgjedhje që thekson ndasitë e roleve gjinore. Personazhet gra dhe vajza që vijnë kryesisht nga bota e artit dhe kulturës, pra hapësira të perceptuara si të lidhura me anën 'femërore' vihen përballë meshkujve nga profesione 'më të forta'. Edhe kur dy personazhe një grua dhe një burrë vijnë nga fusha të ngjashme, mënyra e emërimit të profesionit të tyre, prapë duket sikur i jep përparësi burrave.
- Ka një tendencë për përforcimin e stereotipeve për rolet gjinore, që vërehet tek zgjedhja që iu bëhet pjesëmarrësve në emision.
- Një tendencë e tillë për t'i parë rolet gjinore si 'të ndara me thikë' përforcohet edhe nga narrativa e drejtuesit apo pjesëmarrësve në emision. Ka një ndryshim mes natyrës së pyetjeve që iu bëhen të ftuarëve burra dhe natyrës së pyetjeve që iu bëhen të ftuarave gra.
- 9 herë është vlerësuar se përdorur gjuhë diskriminuese, raciste dhe ofenduese në këto emisione, si më poshtë:

3.1.3 Shembuj

1. Lorenc Vangjeli teksa tregon për restaurimin e një muri në QSUT që sa herë e ndertonin ai binte duke bërë krahasimin me Donatela Versace (ajo ishte si Donatela Versace, e ke parasysh pamjen e saj, nuk kishte make up që ti bente), ndërkohe Blendi Fevziu e pohon.

Emision datës 23.03.2021 Open TV klan.

2. Gjatë të gjithë prezantimit të kandidatës Nisma Thurje Rigerta Loku Tushaj, prezantuesi Blendi Fevziu e përshkruante si person që merret me dhi e dele e jo femerë.

3. Emisioni ka patur gjuhë seksiste si nga të ftuarit burra e gra ashtu edhe nga prezantuesi. Njëra prej të ftuarave, Enida Bozhegu, komentoi e komentoi gjykatësen si një vajzë të bukur fizikisht pa prekur anën profesionale.

4. Blendi Fevziu përveç eksperiencës në punë jep edhe eksperiencën e gjykatëses në Miss Albania në mënyrë tendencioze. Madje thotë se ka patur gra që në emisionet e tij kanë aedhur me veshje tendencioze duke hutuar edhe kameramanet.

Avokati Saimir Visha komentoi se "femra po nuk u tund nuk eshte femer"

5.Seksizem ka qe ne titull te emisionit dhe gjate emisionit ku sipas Blendi Fevziut, krimet dhe vrasjet e grave nga bashkeshortet e tyre i quan krime pasioni.

6. Ne emison ka gjuhe raciste. Dokumentari flet per nje komunitet shqiptarësh qe jetojne ne Johansburg si dhe intervisten me mbretereshen Geraldine. Dokumentari eshte i vitit 1999. Ka gjuhe raciste pergjate te gjithë dokumentarit ku fjala "zezak" eshte perdorur 3 here.

Edhe pse dokumentari eshte i viteve 1999, Fevziu e risjell ne ditet e sotme pa kerkuar ndjese per fjalorin racist te perdorur ne te.

7 .Edi Rama ne do na quanin njerez me seksualitet te dyfishte dhe po te shkonim ne dhembet e medias, ne do perfundonim ne njerez te damkosur.


8.Mirela Miloripolitika eshte si ajo zonja qe ka shume rrudha dhe do botox, problemi eshte qe pasi te kaloje kjo faze te keni po kete dinjitet qe keni edhe tani. Shpresoj qe ta keni, ju zonjat sidomos dhe me pas edhe zoteria.

9. Monika Kryemadhi Eshte shume e veshtire qe nje grua te jete drejtuese qark. Nje grua qe eshte nene dhe qe ka shpenzuar familjen e vet, jeten e vet per te arritur ne ate stad qe eshte e ka shume te veshtire te vendoset perballe nje krimineli. Gruaja eshte shtylla kryesore e shtepise

3.2 Gjetjet në monitorimin e mediave online

Gratë vijojnë të mbetën grupi më i targetuar përsa i përket gjuhës diskriminuese online

- Duke marrë parasysh periudhën para dhe pas zgjedhore më së shumti janë rastet flagrante të targetimit të grave kandidate me qëllim përfitimi politik.
- Disa nga gjetjet më të rëndësishme gjatë kësaj periudhe të monitorimit të medias kanë qenë përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe asaj seksiste ndaj grave dhe vajzave në mediat online. Pjesa më e madhe e shkrimit të artikujve nuk kanë patur një autor.
- Artikujt gjatë periudhës prill kanë patur më tepër në fokus fushatën elektorale dhe zgjedhjet, ndërkohë që është krijuar shumë pak hapësirë për grupet e tjera të marginalizuara. Më tepër fokusi i artikujve ka qenë tek aktualiteti politik dhe kronikat rozë, por shumë pak tek socialet.
- Ndjekësit e Historia Ime gjithashtu kanë raportuar dhjetëra raste gjuhe urrejtjeje dhe diskriminuese, e cila përdoret kryesisht në rrjete sociale apo në portale te ndryshme mediatike online.
- 57 artikuj të monitoruar në dy mediat online, përmbajnë gjuhë të urrejtjes/seksiste/diskriminimit (monitorimi i vitit 2020 evidentoi 293 artikuj në 3 media online).
- Ka një rritje të konsiderueshme në numrin e artikujve me gjuhë seksiste, në të gjitha mediat e monitoruara edhe si pasojë e periudhës zgjedhore.
- Rubrika me përqindjen më të lartë të përdorimit të gjuhës së urrejtjes/seksiste/diskriminuese është rubrika Lifestyle ose rozë.
- Gratë, përbëjnë grupin më të madh të prekur nga gjuha e urrejtjes/seksiste/diskriminuese me 93 % të artikujve. Përqindja e artikujve me gjuhë seksiste dhe diskriminuese përdorur ndaj grave në median online, shënon një rritje nga monitorimi i mëparshëm (2020- artikujt ndaj grave përbënin 68% të totalit të artikujve).



- Gjuha e përdorur ndaj grave në media në më të shumtën e rasteve, lidhet me objektifikimin dhe seksualizimin e tyre, duke përdorur foto që ilustrojnë trupin dhe duke përdorur tituj sensacional me natyrë të nënkuptuar seksuale
- Gjuha e urrejtjes/diskriminuese ndaj grave në media, i referohet në shumicën e rasteve, një karakteristike të grave ose grupit, pra dëmton gratë si grup shoqëror dhe jo persona të veçantë.
- Grupi i dytë më i prekur në median shqiptare nga gjuha e urrejtjes vazhdon të jetë: vetë shqiptarët- 3.5%.
- Grupmosha më e prekur nga gjuha e urrejtjes/diskriminimi ndryshon sipas gjinisë. Kështu për gratë grupmosha më e prekur është 19-35 vjeç.
- Në 48 artikuj ose 84% jepen të gjitha elementet identifikues për viktimat e gjuhës së urrejtjes/seksite/diskriminuese (emir, mbiemri, foto, mosha etj).
- Në 3 artikuj, ka foto reale të subjekteve që janë target për gjuhën e urrejtjes, seksiste, diskriminuese.
- Në 7 artikuj, ka përdorim të gjuhës së urrejtjes/seksiste/diskriminuese, që në titull të artikullit.
- Të gjithë artikujt me gjuhë të urrejtjes/diskriminuese dhe që kanë komente, kanë përdorim të gjuhës së urrejtjes edhe në komente.
- Të gjithë komentet me përdorim të gjuhës së urrejtjes/diskriminimit, janë të pafshirë- në të njëjtën gjendje- edhe disa ditë pas postimit.

3.2.1 Shembuj

Një rast që mund të përmendim është ai i gjyqtarës në Gjykatën e Elbasanit, Enkelejda Kapedani e cila u pezullua për shkak të disa fotove dhe videove personale të publikuara në rrjetin social “Tik Tok”. Ky si lajm mori një bujë të madhe në të gjitha mediat online dhe rrjetet sociale, duke u shoqëruar me gjuhë të papërshtatshme për të diskretuar dhe ofenduar vazhdimisht gjyqtaren, pasi ato ishin video te papërshtatshme për pozicionin dhe punën e saj si dhe thyenin Kodin e Etikës së gjyqtarëve. Sensacionalizimi i rastit në fjalë vihej re që në titull të lajmit, ku rasti shoqërohej me komente të tipit “bënte modeling”; “gjyqtarja e tik-tok” “Gjyqtarja seksi e Elbasanit namin në Tik-Tok”; “Gjyqtarja e ‘Tik-Tok’ shtang hetuesit: Ja kush m’i publikoi videot!” etj.

Në emisionin “Në kurthin e Piter Pan”, i ftuar Spartak Ngjela, po u thonte vajzave të vogla “Duhet të qeshni sepse përndryshe nuk dashurohet askush me ju”. E ndjeva shumë seksiste dhe diskriminuese, ndonëse qëllimi mund të ketë qenë edukativ në këndvështrimin e tij.

Deklaron më sipër një nga ndjekësit tanë, që ju përgjigj thirrjes për raportimin e gjuhës diskriminuese në mediat visive dhe ato online.

Një tjetër shembull negativ, por tepër i përsëritur është objektivizimi i vajzave dhe grave në artikuj, duke u shoqëruar gjithmonë me fjalën foto që në titull: “FOTO| Arjola Demiri: Me mua në pushtet bëni seks dhe qejf.”

Ka pasur gjithashtu dhe raste të gjuhës së papërshtatshme që targeton djemtë dhe burrat, sin ë rastin e një opinion të Enkel Demit i cili bëhet lajm me titullin: “Enkel Demit: Rama,

Erdoganist i pa bërë synet”, por në raport me gratë, burrat janë sërish më pak të ekspozuar ndaj kësaj gjuhe.

Dhuna seksuale, luftë për klikime

Gjatë kësaj periudhe ka patur edhe lajme ku në fokus ka qenë dhuna seksuale dhe përdhunimi i një të miture. Rasti konkret ka qenë i vajzës 15 vjeçare nga Mirdita e cila u përdhunua në grup prej 5 personave.

Ka qenë një numër relativisht i lartë i artikujve dhe shkrimeve nga më të ndryshmet referuar kësaj çështjeje. Ajo që dua të theksoj është se përpos faktit që shumë e kanë përkrahur vajzën dhe zhvlerësuar aktin makabër të këtyre pesë personave, kanë qenë edhe shumë të tjerë të cilët kanë shprehur hapur urrejtje ndaj vajzës me mendimin se ajo e ka pranuar vetë një gjë të tillë.

Përdhunimi i 15-vjeçares në Mirditë/ E mitura në lidhje me 32-vjeçarin e martuar, e mori në makinë dhe abuzoi! Videon ia dha 3 personave të tjerë dhe nipit 17-vjeç.

Prezumimi i fajësisë, zbulimi i identitetit të viktimës dhe autorëve të prezumuar, si edhe publikimi i dëshmive origjinale të hetimit, kanë mbizotëruar në mbulimin mediatic që i është bërë rastit në fjalë.

Abuzimi i 15-vjeçares, shënimet e rojes në mure, babai: Më ka ikur zari, e shihja tek i jepte vajzës karamеле! Djali i ‘monstrës’: E kam rrahur tim atë... Vëllai: E merrnin në makina

Ky monitorim që kemi kryer na ka shërbyer si një formë për të kuptuar se sa janë të prekshme këto fenomene ose problematika sociale dhe si mediat dhe gazetaret i trajtojnë ato. Këtu përfshimë jo vetëm grupet e margjinalizuara, por edhe njerëz apo individ të cilët i përkasin një statusi të caktuar social bazuar në profesionin apo fushën ku ata punojnë.

Gra që ushtrojnë pozita publike, punonjës në institucione dhe personazhe publikë, organizata, përfaqësues dhe përfaqësuese nga media, arti dhe kultura.

Të gjithë këto raste dhe ky monitorim i vazhdueshëm i Historia Ime, tregon se sa larg standardeve etike janë ende mediat kryesore në vend, qofshin ato television, apo media online.

4.Rekomandime

- Emisionet me shikueshmëri të lartë të fashës kryesore orare në të gjithë mediat lokale dhe kombëtare, duhet të angazhohen rregullisht për nxitjen dhe rritjen e pjesëmarrëseve gra dhe vajza si të ftuara, në rubrika të ndryshme të debatit.
- Mediat audiovizive kombëtare dhe lokale duhet të përmirësojnë politikat e tyre editoriale apo të rrisin zbatueshmërinë e tyre me qëllim përmirësimin e raportimit mediatik dhe garantimin e ruajtjes së etikës dhe ndjekjes së parimeve etike të gazetarisë.
- Mediat online në rang vendi duhet të nxisin stafet e tyre editoriale për të shmangur përdorimin e gjuhës seksiste, diskriminuese dhe gjuhës së urrejtjes.
- Mediat online në rang vendi duhet të nxisin stafet e tyre për të marrë përgjegjësi autoriale për lajmet dhe informacionet e publikuara.
- Mediat online në rang vendi duhet të hartojnë kode vetë-rregulluese me qëllim zbatimin e standardeve etike të raportimit, ose në raste të ekzistencës së këtyre kodeve, të angazhohen për zbatueshmërinë më të mirë të tyre.